



BASHKIA MIRDITË

Nr. 3554 Prot.

Rrëshen më 18.9.2020

LËNDA: NJOFTIM ME SHPALLJE PUBLIKE PËR INFORMIMIN E SUBJEKTEVE TË INTERESUARA PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË PRIVATIZIMIT TË ISH-PALLATIT TË GJEOLLOGJISË ME NR.PASURIE 6/44, ZK 3244, LAGJIA I RE, NJËSIA ADMINISTRATIVE RUBIK, BASHKIA MIRDITË.

Në zbatim të nenit 54 të ligjit nr.139/2015''Për Vetëqeverisjen Vendore'', ligjit nr.9232, datë 13.02.2004''Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane''(i ndryshuar), ligjit nr.9235, datë 29.07.2004''Për kthimin dhe kompensimin e pronës'', vkm-së nr.614, datë 07.07.2015''Për përcaktimin e procedurave të privatizimit të banesave dhe objekteve të kthyer në fond banese, e vendime të organeve të qeverisjes vendore dhe të shtetit ku janë sistemuar me strehim banorë të pajisur me autorizim nga organet kompetente'', njoftojmë se ka filluar privatizimi i Pallatit të Ish-Gjeollogjisë me nr.pasurie 6/44, ZK 3244, Lagjia e Re, njësia administrative Rubik. Në bazë të nenit 14, të ligjit nr.9235, datë 29.07.2004''Për kthimin dhe kompensimin e pronave'', ish-pronarëve të truallit u takon e drejta e parablerjes, si dhe në nenin 53 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë:

Bashkia Mirditë ka vendosur të njoftojë publikisht të gjithë subjektet që janë të interesuar për procedurën e privatizimit dhe të drejtës së parablerjes sipas ligjit. Subjektet e interesuar të paraqiten në Bashkinë Mirditë brenda 45 ditëve.

Njoftimit do të afishohet në ambjentet e njësisë administrative Rubik, në ambjentet e bashkisë Mirditë , si dhe në faqen e web-it të bashkisë.

*Njësia administrative Rubik ka detyrimin ligjor të afishojë njoftimin në ambjentet e njësisë së saj.

KRYETARI
Ndrec DEDAJ



ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRËSHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al